


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARIATI

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Komisioni i Financave, Taksave, Revizionimit

Datë 24.3.2026

Lenda: **“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN SHKURT 2026”.**

Analiza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar; Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, I ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, dt.16.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë per vitin 2026”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.1752/prot, dt.24.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.27.01.2026 “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor.

Situata aktuale e funksionit:

Sipas relacionit përmbledhës të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, kryetari i Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak dhe i propozon të vendosë:

1. Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin **Shkurt 2026**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 7, fondi 36.035 lekë.**
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë, për muajin **Shkurt 2026**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr.familjeve 87, fondi 347.538 lekë.**
3. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë , llogaria “Transfertë në buxhetet familjare”.

4. Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare:

Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë. Ilogaria "Transfertë në buxhetet familjare".

Drejtorja/Sektori pergjegjes:

Drejtorja e Shërbimit Social

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtorja e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë dhe Këshilli Bashkiak Kavajë

Impakti social/grupet qe preken:

Familjet në nevojë dhe në kushte të vështira ekonomike.

A eshte objekt konsultimi:

Jo

Komisioni i perhershëm i Financave, Taksave, Revizionimit u mblodhë më datë 24.3.2026 dhe shqyrtoi projekt-vendimin e sipërpërmendur, relacionin dhe dokumentat shoqerues te tij.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozoje Keshillit bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejshem dhe per shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Suzana Arkaxhiu

Genciana Doraci

Shpend Barameta

Bruna Teliti

Hasan Cara

Kryetar

Nen/Kryetar

Anetar

Anetar

Anetar